

ARGUMENTUM



news opinion analysis



PËRMBYLLJA E MISIONIT DIPLOMATIK

Ambasador Dancho Markovski:
“Forcimi i Marrëdhënieve Shqipëri
– Maqedoni e Veriut për një të
ardhme të përbashkët Evropiane”

- Shqipëria çel grup-kapitullin parë me BE-në!

- Lufta dhe Paqja në Izrael: Një realitet i dyfishtë!

- Samiti i dobësisë europiane.

Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,

Argumentum.al tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.

Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.

Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.

Argumentum.al përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare,

politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpunorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.

Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

“Argumentum”, një proces intelektual ...

Marjana DODA
Kryeredaktore

Përmbajtja

03 SPECIALE

- Erdogan viziton Shqipërinë: Marrëveshje të reja dhe Inaugurimi i Xhamisë së Namazgjasë, në fokus Dronët kamikazë

08 INTERVISTA

- Përmbyllja e Misionit Diplomatik/Ambasador Dancho Markovski: “Forcimi i Marrëdhënieve Shqipëri – Maqedoni e Veriut për një të ardhme të përbashkët Evropiane”

12 OP/ED

- Lufta dhe Paqja në Izrael: Një realitet i dyfishtë!

14 POLITIKE

- Arrestohet ish-presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta

15 FOKUS

- Shqipëria çel grup-kapitullin e parë me BE-në!

17 REALPOLITIK

- Samiti i dobësisë europiane! Leyen prapë në Ballkan! Mur i ri anti-perendim!

ENGLISH EDITION

21 ENGLISH TOP NEWS

- Albania Opens EU Accession Negotiations,

22 REALPOLITIK/ A GOOD EUROPEAN JOURNEY!

- Anti-gylenism and neo-ottomanism! Peace, yes, but how! A cold jubilee! A good European journey!

24 OP/ED

-War and Peace in Israel: A Dual Reality!

27 INTERVIEW

- The Conclusion of the Diplomatic Mission / Ambassador Dancho Markovski: Strengthening Albania-North Macedonia Relations for a Shared European Future

30 BALKAN OVERVIEW

- President Erdoğan inaugurates largest mosque in Balkans in Tirana.

31 GLOBAL

- Mark Rutte takes office as NATO Secretary General

Speciale

Erdogan viziton Shqipërinë

Marrëveshje të reja dhe Inaugurimi i Xhamisë së Namazgjasë, në fokus Dronët kamikazë

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, realizoi një vizitë zyrtare në Shqipëri, (10.10) ku u njoftuan disa marrëveshje të rëndësishme. Gjatë kësaj vizite, u inaugurua xhamia më e madhe në Ballkan. Në ceremoninë e inaugurimit të xhamisë, Erdogan theksoi rëndësinë e këtij projekti për forcimin e lidhjeve kulturore dhe historike mes Turqisë dhe Shqipërisë. Xhamia, e cila pritet të jetë një qendër e rëndësishme për komunitetin mysliman, është një simbol i besimit dhe bashkimit mes dy popujve.

Gjatë kësaj vizite u nënshkruan disa marrëveshje që përfshijnë projekte në infrastrukturë, arsim dhe turizëm, që synojnë të forcojnë më tej partneritetin strategjik midis dy vendeve. Kjo vizitë shënon një hap të rëndësishëm në thellimin e lidhjeve turko-shqiptare dhe në promovimin e stabilitetit dhe zhvillimit në rajon.

Erdogan gjithashtu risolli në vëmendje kërcënimin nga Organizata FETO, e cila, sipas tij vijon të jetë ekzistent edhe në Shqipëri.

Kjo vizitë ka si qëllim edhe përmirësimin e sigurisë dhe stabilitetit në Ballkan, në një kohë kur sfidat rajonale kërkojnë përgjigje të përbashkëta. Si një shenjë e forcimit të bashkëpunimit ushtarak, Turqia ofroi dy dronë kamikaze, duke theksuar rëndësinë e partneritetit strategjik midis dy vendeve.



Në axhendën e tij një ditore Presidenti turk dhe delegacioni i tij zhvilluan një takim në Presidencë me presidentin e Shqipërisë, z. Bajram Begaj.

Më pas, Presidenti turk vijoi axhendën e tij me takimin kokë më kokë me kryeministrin Edi Rama. Takimi u pasua nga firmosja e disa marrëveshjeve bilaterale dhe një konferencë e përbashkët shtypi.

Më pas, Presidenti Erdogan së bashku me kreun e qeverisë shqiptare, inauguruan xhaminë e Namazgjasë në Tiranë.

Gjatë vizitës së tij në Shqipëri, Erdogan po shoqërohet nga zonja e parë Emine Erdoğan, ministri i Jashtëm Hakan Fidan, ministri i Industrisë dhe Teknologjisë

Mehmet Fatih Kacı, ministri i Tregtisë Ömer Bolat, ministri i Rinisë dhe Sportit Osman Aşkın Bak, ministri i Bujqësisë dhe Pylltarisë İbrahim Yumaklı, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës Abdulkadir Uraloğlu, ministri i Energjisë dhe Burimeve Natyrore Alparslan Bayraktar, kreu i Kryesisë së Komunikimeve pranë Presidencës Fahrettin Altun, kreu i inteligjencës (MIT) İbrahim Kalın, kreu i Çështjeve Fetare Ali Erbaş, kryekëshilltari i Presidentit për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Akif Çağatay Kılıç dhe kreu i Industrisë së Mbrojtjes, Haluk Görğün.

Argumentum.al sjell disa nga pikat kyçe të zhvillimit të kësaj

axhende gjatë vizitës së tij në Shqipëri:

Bashkëpunimi i nivelit të lartë Shqipëri-Turqi, nënshkruen dhe 3 marrëveshje bashkëpunimi

Gjatë vizitës së presidentit turk Recep Tayyip Erdoğan në Shqipëri janë nënshkruar 4 marrëveshje midis Turqisë dhe Shqipërisë në fushat e bashkëpunimit, komunikimit, arsimit dhe bujqësisë.

Nënshkrimi i marrëveshjeve është bërë para konferencës së përbashkët për media.

Presidenti Erdoğan dhe kryeministri Rama nënshkruan Deklaratën e Përbashkët për Thellimin e Partneritetit Strategjik të vendosur me krijimin e Këshillit të Bashkëpunimit të Nivelit të Lartë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Memorandumi i Mirëkuptimit për Bashkëpunimin në fushën e Marrëdhënieve me Publikun dhe Komunikimit ndërmjet Turqisë dhe Shqipërisë u nënshkrua nga kreu i Komunikimeve pranë Presidencës turke, Fahrettin Altun, dhe Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë për Media dhe Informim i Republikës së Shqipërisë, Alteo Hysi.

Deklarata e synimit për bashkëpunim në fushën e sigurimeve bujqësore të mbështetura nga shteti ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe të Pylltarisë së Republikës së Turqisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe të Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë u nënshkrua nga ministri turk Ibrahim Yumaklı dhe ministri shqiptar Anila Denaj.

Ndërkaq, protokollin për Hapjen e Degëve dhe Programeve Akademike të Universitetit Tek-

nik të Istanbulit në Shqipëri, ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe të Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Kryesisë së Këshillit të Arsimit të Lartë të Republikës së Turqisë, u nënshkrua nga kryetari i Këshillit të Arsimit të Lartë (YÖK), Erol Özvar, dhe ministri shqiptar Ogerta Manastirliu.

Po ashtu, mes dy vendeve u nënshkrua memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Agjencisë për Media dhe Informim të Republikës së Shqipërisë dhe Drejtorisë së Komunikimit të Presidencës së Republikës së Turqisë për bashkëpunim në fushën e marrëdhënieve me publikun dhe komunikimin. Për palën shqiptare memorandumi u firmos Alteo Hysi, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë për Media dhe Informim

dhe për palën turke Fahrettin Altun, Drejtor i Komunikimit të Drejtorisë së Komunikimit të Presidencës së Republikës së Turqisë.

Konferenca e përbashkët

Erdoğan-Rama

Presidenti Erdoğan dhe kryeministri shqiptar Edi Rama zhvilluan konferencë të përbashkët për shtyp pas takimit të tyre në Kryeministri, Takimit të Dytë të Këshillit të Bashkëpunimit të Nivelit të Lartë dhe ceremonisë së nënshkrimit të marrëveshjeve midis dy vendeve.

Duke u shprehur se është i lumtur që ndodhet në vendin mik dhe vëllazëror të Shqipërisë, Erdoğan tha: “Siç e dini, vitin e kaluar ne festuam 100-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve tona diplomatike me Shqipërinë. Marrëdhëniet tona miqësore me Shqipërinë, të forcuara nga lidhjet historike dhe afërsia kulturore, në fakt shtrihen përtej një shekulli”.

Ai tha se me diskutimet e sotme e thelluan më tej partneritetin strategjik të vendosur në vitin 2021 mbi këtë themel historik, njerëzor dhe kulturor, duke shtuar se gjatë takimit shkëmbyen mendime të detajuara për fushat e bashkëpunimit të përcaktuara në takimin e parë të Këshillit të mbajtur në Ankara në shkurt 2023.

Erdoğan tha se me Deklaratën e Përbashkët të nënshkruar theksuan vendosmërinë për të zhvilluar dhe thelluar Këshillin në fusha të ndryshme.

Ai tha se kanë “konfirmuar vullnetin e dy vendeve për të avancuar bashkëpunimin” me marrëveshjet që u nënshkruan sot në fushën e bujqësisë, arsimit të lartë dhe marrëdhënieve me

“Ne jemi të interesuar dhe të përbushur sot pas konfirmimit të një etape të re në fuqizimin e industrisë ushtarake të Shqipërisë dhe fuqizimin e kësaj marrëdhënie në aspektin ushtarak, ku dihet botërisht se Turqia ka arritur nivel shumë të lartë për prodhimin e industrisë ushtarake. E çmoj dhuratën e Presidentit sot në këtë kohë të trazuar, ku bota ka marrë një drejtim të çuditshëm, thënë me një fjalë të butë, për t'i dhënë ushtrisë shqiptare një numër të konsiderueshëm dronësh kamikazë”, tha kryeministri Rama.

publikun dhe komunikimit.

Nga ana tjetër kreu i qeverisë shqiptare, Edi Rama u ndal edhe te bashkëpunimi dhe rritja e ndërveprimit ekonomik mes dy vendeve.

“Së pari, dua të përsëris edhe njëherë, për të disatën herë qysh kur presidenti ka ngjitur shkallët e kësaj godine, falënderimet dhe shprehjen më të sinqertë të mirënjohjes për vizitën sot në Tiranë, së bashku me një pjesë të konsiderueshme të ekipit të tij qeveritar. Ejvallah!

Jam vërtetë shumë i kënaqur që zhvilluam takimin e dytë të Këshillit të nivelit të lartë të Bashkëpunimit ku jo vetëm konfirmuam vendosmërinë për ta forcuar më tej karakterin strategjik të këtij bashkëpunimi por edhe mundën të vlerësojmë zbatimin konkret të marrëveshjeve të bëra si edhe potencialin e jashtëzakonshëm të kësaj marrëdhënieje.

Turqia dhuron dronë kamikazë, Rama: Mesazh i qartë se Shqipëria është e pagoditshme
Kryeministri Edi Rama bëri të ditur sot se se Turqia i ka dhuruar Shqipërisë disa dronë kamikazë. Në deklaratën e përbashkët për shtyp me presidentin e Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan, i cili po viziton sot Tiranën, Rama tha se sot nis një etapë e re në fuqizimin e industrisë ushtarake të Shqipërisë.

“Ne jemi të interesuar dhe të përmeshur sot pas konfirmimit të një etape të re në fuqizimin e industrisë ushtarake të Shqipërisë dhe fuqizimin e kësaj marrëdhënie në aspektin ushtarak, ku dihet botërisht se Turqia ka arritur nivel shumë të lartë



për prodhimin e industrisë ushtarake. E çmoj dhuratën e Presidentit sot në këtë kohë të trazuar, ku bota ka marrë një drejtim të çuditshëm, thënë me një fjalë të butë, për t'i dhënë ushtrisë shqiptare një numër të konsiderueshëm dronësh kamikazë”, tha kryeministri Rama.

Rama tha se ky është një mesazh i qartë se Shqipëria është e pagoditshme.

“Nuk duhet të shqetësojë askënd se kë do godasë Shqipëria, por që përmban brenda një mesazh të qartë të Turqisë në raport me këtë marrëdhënie, atë që Shqipëria është e pagoditshme”, deklaroi Rama.

Gaza dhe FETO, – dy pakënaqësitë e Presidentit Erdogan
Presidenti turk Erdogan, gjatë deklaratës për shtyp, me kryeministrin Rama tha se shpreson që bashkë me Shqipërinë të vazhdojnë luftën kundër organizatave terroriste, kundër FETO. *Disputuam edhe çështjen e luftës kundër organizatave terroriste, kundër FETO, me mikun tim të dashur Ramën. Shpresoj që ta vazhdojmë luftën tonë kundër*

organizatave terroristeve përmes vendimeve që kemi marrë sot.

Njëkohësisht Presidenti turk Erdogan u ndal dhe tek lufta në Lindjen e Mesme, duke theksuar se Genocidi në Gaza është turpi i njerëzimit, madje kerkoj që dhe Shqipëria të bëjë pjesën e saj.

“Ne ndjekim përpjekjet për të vendosur paqe dhe stabilitet në rajon. Mizoritë izraelite në territoret palestineze ishin ndër pikat prioritare të agjendës sonë. Unë ndava pikëpamjet tona për agresionin e Netanyahu. Gjenocidi në Gazë është turpi ynë i përbashkët, i të gjithë njerëzimit. Ne si ndërkombëtar duhet të bëjmë çmos të sigurojmë armëpushim të përherëshëm për të ofruar ndihma humanitare dhe të bëjmë presionin e nevojshëm mbi Izraelin. Sinqerisht besoj se Shqipëria do të bëjë pjesën e saj në këtë drejtim”, tha ai.

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan gjatë konferencës së përbashkët me kryeministrin Edi Rama bëri me dije se kanë diskutuar edhe për çështjet globale dhe rajonale.

Erdogan deklaroi se genocidi në Gaza është turpi i përbashkët i

të gjithë njerëzimit, ku shtoi se duhet të bëhet presion ndaj Izraelit për armëpushim. Gjithashtu, Erdoğan i përsëriti kryeministrit Edi Rama për luftën kundër organizatës “FETO”, siç e konsideron ai, njerëzit e filantropit Fethullah Gülen.

“Diskutuam edhe çështjen e luftës së përbashkët kundër organizatave terroriste, FETO-s me mikun tim të dashur kryeministrin Rama. Shpresojmë që ta vazhdojmë luftën kundër organizatave terroriste përmes vendimeve që kemi marrë sot.

Me zotën kryeministër shkëmbyem ide edhe për çështje globale dhe rajonale. Ndjekim me admirim përpjekjet e Shqipërisë për vendosjet e paqes dhe stabilitetit si në rajon dhe në arenën ndërkombëtare. Mizoritë izraelite në territoret e pushtuara palestineze, në Gaza dhe Liban, ishin ndër pikat prioritare të takimit tonë. Unë ndava pikëpamjet tona për agresionit e qeverisë Netanyahu që shkojnë përtej fushëveprimit rajonal dhe janë bërë kërcënim për rendin global. Gjenocidi prej 1 viti në Gazë është turpi i përbashkët i të gjithë njerëzimit. Për këtë arsye, ne si komunitet ndërkombëtar duhet të bëjmë çmos për një armëpushim të përhershëm



Ndjekim me admirim përpjekjet e Shqipërisë për vendosjet e paqes dhe stabilitetit si në rajon dhe në arenën ndërkombëtare. Mizoritë izraelite në territoret e pushtuara palestineze, në Gaza dhe Liban, ishin ndër pikat prioritare të takimit tonë. Unë ndava pikëpamjet tona për agresionit e qeverisë Netanyahu që shkojnë përtej fushëveprimit rajonal dhe janë bërë kërcënim për rendin global. Gjenocidi prej 1 viti në Gazë është turpi i përbashkët i të gjithë njerëzimit.



për të ofruar ndihma humanitare dhe presion ndaj Izraelit. Besoj se Shqipëria do të bëjë pjesën e saj në këtë drejtim.”, u shpreh Erdogan.

Nga ana tjetër, kryeministri Edi Rama deklaroi se pika ku ndahen Tirana dhe Ankaraja sa i përket qëndrimit për konfliktin mes Izraelit dhe Gazës është Hamasi dhe terrori i ushtruar prej tyre. Shefi i qeverisë shqiptare u shpreh se Shqipëria është pro një armëpushimi që duhet të kushtëzohet me lirin e pengjeve dhe zgjidhjes për paqe afatgjatë me dy shtete, duke pranuar se duhet të krijohet shteti i Palestinës.

“Në një pikë kemi një këndvështrim të ndryshëm, sepse duke qenë tërësisht të vendosur bashkë me Republikën e Turqisë dhe me shumë të tjerë, po flas për këtë marrëdhënie kundër terrorizimit, kundër terrorit. Për ne terrori në çdo formë dhe me çdo pamje që të shfaqet është i pa tolerueshëm. Ne jemi absolutisht dhe kemi votuar në Këshillin e Sigurimit për një armëpushim, që patjetër duhet të nënkuptojë dhe lirin e menjëhershëm të të gjitha pengjeve, por për ne Hamasi dhe çdo burim tjetër i terrorit nuk ka vend në të ardhmen paqësore”, tha Rama.





Në vijim kryeministri deklaroi se ai dhe Erdogan ndajnë të njëjtin qëndrim për faktin se populli palestinez ka të drejtën të jetojë i lirë, duke pranuar se duhet të krijohet shteti i Palestinës.

– Xhamia e Namazgjasë-Simbol i Unitetit

Në fund të kësaj vizite u mbajt dhe ngjarja e shumëpritur për besimtarët myslimanë.

Xhamia e shumëpritur e Namazgjasë hap dyert për besimtarët myslimanë

Xhamia e Namazgjasë çel dyert për besimtarët myslimanë. Kryeministri Edi Rama së bashku me Presidentin e Republikës Turke, Recep Tayyip Erdoğan inauguruan xhaminë.

Kryeministri Rama dhe Presidenti i Turqisë iu drejtuan me një fjalë të gjithë besimtarëve të mbledhur me rastin e hapjes së xhamisë, çka shënon dhe një ditë të rëndësishme për të gjithë komunitetin mysliman shqiptar.

Xhamia e Namazgjasë në Tiranë u përrua në një ceremoni të veçantë ku ishte i pranishëm edhe presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan dhe kryeministri Edi Rama.

Në fjalën e mbajtur në këtë ceremoni, kryeministri Edi Rama vlerësoi se çelja e kësaj xhamie ishte e shumëpritur nga komuniteti mysliman.

“Ja ku erdhi dita e çeljes së këtij tempulli të adhurimit të krijuesit të botëve, kaq i shumëpritur nga komuniteti mysliman në rrjedhën e viteve për aq shumë arsye. Kjo faltore që frymo nga një besim universal, Xhamia e Madhe e Namazgjasë, është tanimë trashëgimia e një popullit të tërë, e cila mishëron atë që Profeti, paqja e Zotit qoftë mbi të, ka thënë për veten: ‘Unë jam lutja e Ibrahimit, sihariqi i saj dhe ëndrra e nënës time’”, tha Rama në fjalën e tij.

Kryeministri vlerësoi se kjo xhami i jep domethënien e plotë dhe

kuptimplotë katrorit të katër faltoreve të kryeqytetit.


Rama tha se “si çdo faltore tjetër e këtij vendi ku gjen paqe çdo shqiptar që i falet Zotit në besimin e vetë, kjo Xhami e Madhe e Namazgjasë është tani një vend i shenjtë”.

“E këtij vendi nuk mund t’i këndohet sot më mirë se sa në shqipen e Haxhi Hafiz Ibrahim Dalliu: I dashuri im kujtoje edhe atë kohë kur ne me madhërinë tonë e bëmë Qabënë vend shpërblimi dhe kthimi për njerëzit, e bëmë edhe vend të sigurt. Epo qoftë me jetë dhe gjithëjetë kjo faltore një shëmbëlltyrë e vizionit të Qabesë, një shtëpi e shpërblimit dhe e kthimit, vend i sigurt për të gjithë fëmijët e Ibrahimit”, tha Rama.

Dhjetëra besimtarë ishin mbledhur para xhamisë, në pritje të kësaj ngjarjeje të shënuar për komunitetin mysliman shqiptar.

Xhamia e Namazgjasë konsiderohet më e madhja në Ballkan dhe është realizuar si një dhuratë e popullit turk për besimtarët myslimanë në Shqipëri.

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdoğan, në inaugurimin e xhamisë së Namazgjasë në Tiranë ka deklaruar se kjo xhami do të jetë një simbol i lidhjeve miqësore midis Turqisë dhe Shqipërisë.



“Forcimi i Marrëdhënieve Shqipëri – Maqedoni e Veriut për një të ardhme të përbashkët Evropiane”

Intervistë Ekskluzive për ARGUMENTUM.al me Ambasadorin e Maqedonisë së Veriut në Tiranë, Sh.T.Z. Dancho Markovski

Kryediplomati i Shkupit në Tiranë, Sh.T.Z. Dancho Markovski, ka përmbyllur jo vetëm mandatin e tij diplomatik në Shqipëri, por gjithashtu edhe karrierën e tij të shërbimit diplomatik pas katër dekadash.

“Shqipëria ishte ndalesa e shtatë e fundit e udhëtimit tim diplomatik nëpër botë”. Pas gati 40 vitesh shërbim diplomatik, më në fund po e përfundoj angazhimin tim të punës. Jam i kënaqur që në të ardhmen do të kem mundësi të përkushtohem punës arsimore teorike në një universitet të njohur në Shkup”, shprehet Ambasador Z. Dancho Markovski në këtë intervistë ekskluzive për Argumentum.al.

Në këtë intervistë, Ambasadori ofron një pasqyrë të hollësishme mbi sfidat dhe sukseset gjatë mandatit të tij, duke përmendur ndër arritjet më të rëndësishme hapjen e Qendrës Informative Kulturore Maqedonase në Tiranë dhe zhvillimin e marrëdhënieve kulturore dhe akademike mes dy shteteve. Gjithashtu, ai adreson sfidat e përbashkëta, si dhe rëndësinë e përmirësimit të bashkëpunimit ekonomik dhe avancimin e perspektivës evropiane të Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë.



“Në lidhje me mandatin tim katërvjeçar, aktivitetet e mia të përditshme i kam fokusuar në zbatimin e qëllimeve të politikës së jashtme të Maqedonisë së Veriut, përkatësisht: Politikës për zhvillimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë ndërmjet dy vendeve; Rritja e bashkëpunimit dypalësh ekonomik dhe tregtar; Riemërtimi i përfaqësimit kulturor të Maqedonisë së Veriut; dhe Bashkëpunimi me shoqëritë kulturore të maqedonasve në Shqipëri në drejtim të mbrojtjes së veçantisë së tyre etnike, gjuhësore dhe kulturore”, thekson ai duke bere nje bilanc te punes dhe misionit te tij diplomatik ne Tirane.

Hapja e Qendrës Informative Kulturore Maqedonase në Tiranë është një arritje kyçe, duke ofruar mundësi për promovi-

min e kulturës maqedonase dhe mbrojtjen e diversitetit etnik dhe kulturor. Po ashtu, avancimi i mësimin të gjuhës maqedonase në universitete ka pasur ndikim të rëndësishëm. Ky është një gur themelor që u vendos falë angazhimit të veçantë të Ambasadorit Markovski.

Ne lidhje me bashkëpunimi ekonomik mes dy vendeve, Ambasadori thekson se ndonese bashkëpunimi ekonomik ka perparuar, ka ende ka hapësirë për rritje të shkëmbimeve tregtare mes dy vendeve. Ai beson se potenciali ekonomik mbetet i pasfrytëzuar, dhe shpreson për formimin e një komiteti të përzier ndërqeveritar për të mbështetur zhvillimin ekonomik. Në fushën kulturore, ai pret që bashkëpunimi të thellohet.

Një nga sfidat kryesore gjatë këtij mandati diplomatik ka qenë procesi i regjistrimit të popullsisë në Shqipëri, veçanërisht lidhur me Censusin 2023 për minoritetin maqedonas. Ky proces ka shkakuar diskutime dhe kontestime, dhe është një prej pikave që Ambasadori ka vlerësuar si problematike. Ai thekson se censusi i vitit 2023 ka pasur mangësi në implementimin e tij, përfshirë trajnimin e pamjaftueshëm të regjistruarëve dhe informacionin e gabuar që u është dhënë qytetarëve në lidhje me përkatësinë etnike. Ambasadori shpreh shqetësim për numrin e ulët të maqedonasve të regjistruar dhe thekson rëndësinë e ruajtjes së identitetit të këtij grupi etnik.

“Rezultati i kësaj është fitimi i një numri mbresëlënës të një pakice, e cila nuk ka ekzistuar në regjistrimet e popullsisë në vend, për dallim nga të tjerët, veçanërisht nga ai maqedonas. Para dhe gjatë



Në periudhën e kaluar, të dy vendet gjeneruan stabilitet në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke promovuar dialogun dhe kompromisin si mjetet më të pranueshme për tejkalimin e çështjeve të hapura. Një dialog intensiv politik dhe komunikim i ndërsjellë u realizua përmes takimeve dhe kontakteve të shpeshta në të gjitha nivelet. Konfirmim i kësaj ishiny dy mbledhje të përbashkëta qeveritare të mbajtura bashkërisht në Pogradec dhe Shkup.



regjistrimit, u zhvillua një inxhinieri interesante pasaportash. Sa për maqedonasit, ata ende mbeten qytetarë besnikë të shtetit shqiptar. Ata do të vazhdojnë me aktivitetet e tyre për ruajtjen e identitetit të tyre etnik, gjuhësor dhe kulturor. Historia e pasaportave të palëve të treta do të bëhet e parëndësishme në momentin që Shqipëria të bëhet anëtare e BE-së”, shprehet Ambasadori.

I pyetur për zhvillimet ndërkombëtare dhe ndikimin e tyre në rajonin tonë, si diplomat karriere, Ambasadori u shpreh se, megjithëse rajoni i Ballkanit është një pikë kritike ndërkombëtare, nuk ka rrezik për destabilizim serioz. Ai theksoi se shumica e shteteve të Ballkanit janë anëtarë të NATO-s ose janë në proces të anëtarësimit, dhe kujtimet e konflikteve të ish-Jugosllavisë e bëjnë të paimagjinueshëm një tjetër lëvizje të paarsyeshme. Ambasadori vuri në dukje se një faktor që kontribuon në rritjen e populizmit dhe nacionalizmit janë ngadalësimi i integritetit të vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE, çka lejon politikanët të përhapin ide të tilla, ndërkohë që rinia largohet drejt vendeve evropiane.

INTERVISTA E PLOTË:

Znj. Marjana Doda: I nderuar Ambasador, faleminderit për mundësinë e kësaj interviste, e cila vjen si një pasqyrim i punës suaj diplomatike në Shqipëri, në përmblyllje të mandatit tuaj si Ambasador i Maqedonisë së Veriut. Ndaj pyetja e pare lind natyrshëm, si e vlerësoni këtë mandat si Ambasador i RMV-se në Shqipëri, dhe cilat kanë qenë zhvillimet më të rëndësishme

gjatë periudhës së angazhimit tuaj diplomatik?

Sh.T.Z Dancho Markovski: Shqipëria ishte ndalesa e shtatë e fundit e udhëtimit tim diplomatik nëpër botë. Pas gati 40 vitesh shërbim diplomatik, më në fund po e përfundoj angazhimit tim të punës. Jam i kënaqur që në të ardhmen do të kem mundësi të përkushtohem punës arsimore teorike në një universitet të njohur në Shkup.

-Si e vlerësoni marrëdhënien midis Maqedonisë dhe Shqipërisë gjatë mandatit tuaj? Cilat ishin sfidat kryesore që hasët gjatë këtij mandati?

Si fqinjë të afërt, gjëja më domethënëse është se të dyja palët ruajtën angazhimin e tyre për bashkëpunim përmes dialogut të hapur dhe konstruktiv politik, si mënyra më e pranueshme e mundshme për të ndërtuar marrëdhënie të mira fqinjësore dhe një vizion të ndërsjellë për një rajon të begatë dhe të ndërlidhur, të integruar në NATO dhe BE. Në periudhën e kaluar, të dy vendet gjeneruan stabilitet në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke promovuar dialogun dhe kompromisin si mjetet më të pranueshme për tejkalimin e çështjeve të hapura. Një dialog intensiv politik dhe komunikim i ndërsjellë u realizua përmes takimeve dhe kontakteve të shpeshta në të gjitha nivelet. Konfirmim i kësaj ishiny dy mbledhje të përbashkëta qeveritare të mbajtura bashkërisht në Pogradec dhe Shkup. Vizitat e presidentëve, kryeparlamentarëve, takimet e shpeshta të kryeministrave dhe ministrave të qeverisë rezultuan në marrëveshje të shumta dypalëshe në fusha me interes të përbashkët.

-Cilat janë arritjet më të rëndësishme në marrëdhëniet dypalëshe midis Shqipërisë dhe Maqedonisë gjatë mandatit tuaj që dëshironi ti nënvizoni?

Ndër më të rëndësishmet do të veçoja hapjen e Qendrës Informative Kulturore Maqedonase në Tiranë, e cila krijoi mundësi për një prezantim më të gjerë kulturor të vendit tonë, si dhe riemërtimin e kulturës maqedonase dhe përfaqësimin kulturor të vendit tonë para publikut shqiptar, me qëllim paraqitjen e imazhit të ri të vendit tonë. Qendra është gjithashtu një mundësi për një artikulum më serioz të aktiviteteve të maqedonasve, duke treguar diversitetin e shoqërisë shqiptare.

Me rëndësi të veçantë ishin iniciativat për hapjen e lëndës së gjuhës maqedonase në Fakultetin Filozofik në Universitetin "Fan S. Noli" në Korçë, si dhe rivitalizimi i Departamentit të Gjuhës Maqedonase në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës, pas më shumë se tetë vitesh. Ndryshe nga Universiteti i Korçës, ku pritet regjistrimi i studentëve të parë, në Fakultetin e Tiranës, vitin e kaluar u diplomua grupi i parë i studentëve, kurse nga ky vit, përveç mësimit të rregullt, gjuha maqedonase futet në grupin e gjuhëve fakultative për studime pasuniversitare.

-Një prej çështjeve më të diskutuara këto kohë është perspektiva e Ballkanit Perëndimor për integrimin në Bashkimin Evropian. Si e shihni rrugëtimin evropian të Maqedonisë së Veriut tani që është ndarë nga Shqipëria në këtë proces?

Maqedonia e Veriut do të vazh-



dojë në rrugën e saj integruese deri në anëtarësimin përfundimtar në Bashkimin Evropian. Që nga dita e pavarësisë sonë, synimet më të rëndësishme të politikës së jashtme kanë qenë anëtarësimi në NATO dhe BE. Është investuar shumë në atë rrugë, për fat të keq, të mprehtë dhe të padrejtë, por duhet ndjekur deri në fund. Ndarja nga Shqipëria në asnjë mënyrë nuk do të thotë se administrata maqedonase ndaloi me procesin e përmbushjes së kriterëve të nevojshme. Një përqindje e lartë e përputhshmërisë me legjislacionin evropian u arrit në disa grupime. Ekipet negociuese po punojnë shumë dhe janë në kontakt të vazhdueshëm me Komisionin Evropian. Besoj se edhe kjo pengesë nga ana e një nga vendet tona fqinje do të kalojë. Maqedonia e Veriut do të bëhet anëtare e BE-së.

- Si e vlerësoni ndikimin e bashkëpunimit ekonomik dhe kulturor në forcimin e marrëdhënieve mes Maqedonisë dhe Shqipërisë? -Cilat janë fushat ku mendoni se mund të arrihen përmirësime?

Vlerësimi i përgjithshëm i bashkëpunimit ekonomik dypalësh është se ai ende nuk bash-

këpunon me nivelin e arritur të marrëdhënieve politike dhe gatishmërinë e shprehur reciprokisht për avancimin e tij. Fakti që të dyja vendet nuk janë në listat e tyre të 20 partnerëve më të rëndësishëm ekonomikë e konfirmon këtë gjë. Hapi i bërë në shkëmbimin e mbi 230 milionë eurove, krahasuar me vitin 2018, kur varionte nga rreth 150 milionë euro, është ende i pamjaftueshëm duke marrë parasysh mundësitë dhe potencialin ekzistues, duke u nisur nga kuadri ligjor i rregulluar, afërsia, lidhja rrugore, kufiri i përbashkët etj. Pres që në periudhën e ardhshme të ketë përpjekje nga të dyja vendet që do të kontribuojnë në rritjen e bashkëpunimit ekonomik. Shpresoj se në mbështetje të këtyre angazhimeve do të jetë edhe formimi i komitetit të përzier ndërqeveritar për bashkëpunim ekonomik.

Nga pjesa tjetër mbetet nevojja për miratimin e akteve nënligjore që do të mundësojnë studimin e gjuhës maqedonase jo vetëm në Pustec, por edhe në zona të tjera ku ka interes për të. Bashkëpunimi kulturor do të vazhdojë të zgjerohet dhe thellohet.

-Censuri i vitit 2023 në Shqipëri ka sjellë diskutime dhe kontes-

time. Si e vlerësoni rezultatin e censusi për minoritetin maqedonas, sidomos në lidhje me numrat e ulët të raportuar? Cilat janë shqetësimet tuaja për këtë grup minoritar në kuadër të këtij censusi?

Përkundër faktit se regjistrimi u shty për një vit për t'u realizuar më mirë, ai fatkeqësisht nuk i përmbushi pritjet e mia, por as të përfaqësuesve të pakicave, të besimeve fetare dhe të tjerëve. Mënyra se si u zbatua në mjediset ku jetojnë maqedonasit nuk i plotësonte standardet e nevojshme. Trajnimi i pamjaftueshëm i regjistruarëve, informimi i pamjaftueshëm i personave të regjistruar, veçanërisht në lidhje me përkatësinë e tyre etnike dhe fetare, plotësimi arbitrar i formularëve, mosrespektimi i afatit kohor për regjistrim, pra lënia e personave të paregjistruar që nuk kanë qenë të pranishëm në këtë moment, janë vetëm një pjesë e parregullsive që hedhin njollë në korrektësinë e regjistrimit. Për këto probleme ka pasur reagime edhe nga shoqëritë maqedonase. Rezultati i kësaj është fitimi i një numri mbresëlënës të një pakice, e cila nuk ka ekzistuar në regjistrimet e popullsisë në vend, për dallim nga të tjerët, veçanërisht nga ai maqedonas. Para dhe gjatë regjistrimit, u zhvillua një inxhinieri interesante pasaportash. Sa për maqedonasit, ata ende mbeten qytetarë besnikë të shtetit shqiptar. Ata do të vazhdojnë me aktivitetet e tyre për ruajtjen e identitetit të tyre etnik, gjuhësor dhe kulturor. Historia e pasaportave të palëve të treta do të bëhet e parëndësishme në momentin që Shqipëria të bëhet anëtare e BE-së.

-Si diplomat me përvojë në rajon dhe në botë, do të ishte interesante të dëgjoni mendimin tuaj mbi zhvillimet gjeopolitike të viteve të fundit. Si e shihni rolin e fuqive të mëdha, si SHBA, Rusia dhe Kina, në formësimin e politikave gjeopolitike në rajon?

Në periudhën në vijim, shpresoj se do të ketë një reduktim të caktuar të konflikteve aktuale ushtarake dhe do të forcohen përpjekjet për të gjetur një zgjidhje paqësore. Bota nuk është gati për një luftë bërthamore në të cilën të gjithë do të jenë humbës. Arsyeja duhet të mbizotërojë. Administrata e re amerikane pritet të sjellë disa ndryshime në politikën e jashtme të vendit. Një riorganizim i ri në sferat ekonomike të interesit është në horizont. Gara mes SHBA-së, Kinës, Indisë, Rusisë, si dhe disa fuqive rajonale për primatin dhe ndikimin më të madh në botën shumëpolare do të vazhdojë. Kështu që bota krejtësisht kaotike që njihnim do të hyjë në një fazë të re të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Sa i përket shteteve në rajonin tonë, nuk duhet të presim zhvillime të trazuara. Shumica e vendeve nga Ballkani Perëndimor kanë një vizion të qartë përparëdimor. Përpjekjet për ndikim më të madh nga disa fuqi të mëdha kanë ekzistuar gjithmonë. Pyetja është se sa dhe cila është gatishmëria e BE-së për t'i pranuar ato dhe përfundimisht për të përmbyllur integritetin e saj.

-A mendoni se ka ndonjë rrezik të mundshëm për stabilitetin në rajon si rezultat i këtyre zhvillimeve?

Pavarësisht se rajoni ynë trajto-

het si pikë kritike, nuk mendoj se ka ndonjë rrezik për destabilizim më serioz. Shumica e vendeve të Ballkanit janë anëtarë të NATO-s ose po bëjnë përpjekje për t'u bashkuar kësaj aleance. Kujtimet e konflikteve ushtarake në shtetin e ish-Jugosllavisë janë ende të freskëta për dikë që të synojë një lëvizje të paarsyeshme. Ajo që, sipas mendimit tim, në një farë mënyre kontribuon në dëshimin e ideve nacional-shoviniste nga politikanë vendas, të cilët në mungesë të vizionit përpiqen të shpallin populizëm të lirë dhe kërcënime, është integrimi i ngadaltë i vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Lënia e padrejtë e rajonit në një rrugë të diskutueshme jashtë kornizës evropiane e bën të pamundur evropianizimin e rajonit. Dhe pikërisht kjo është hapësira në të cilën ky lloj politikani shpall të papenguar populizmin ndërsa të rinjtë largohen drejt vendeve evropiane.

-Çfarë mesazhi dëshironi të lini pas për marrëdhëniet mes dy vendeve, duke u fokusuar në zhvillimet e ardhshme dhe perspektivat për bashkëpunim mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut?

Pres që të ruhet shkalla pozitive e marrëdhënieve të ndërsjella. Mungesa e çështjeve të hapura është një bazë e mirë për ndërtimin e miqësisë mes dy vendeve dhe popujve të tyre.

Sëfundmi Z. Ambasador,

Deshiroj të shpreh falenderimet e mia për frymën e bashkëpunimit që keni promovuar, jo vetëm në nivelin institucional midis dy vendeve tona, por edhe për gatishmërinë tuaj për të bashkëpunuar me mediat. Faleminderit!



Nga Gledis NANO*

Koncepti i paqes dhe luftës është thellësisht i ndërthurur me historinë dhe të tashmen e Izraelit. Që nga themelimi i tij në 1948 deri në konfliktet e tij të vazhdueshme, ekzistenca e Izraelit është përcaktuar nga një realitet i dyfishtë: shpresa për paqe të qëndrueshme dhe kërcënimi i vazhdueshëm i luftës. Kjo marrëdhënie komplekse ngre pyetje të rëndësishme nëse paqja mund të arrihet pa konflikt apo nëse lufta është një hap i pashmangshëm në rrugën e pajtimit. Përvoja Israelite ofron një lente unike përmes së cilës mund të eksplorohet paradoksi i luftës dhe paqes, ku të dyja bashkëjetojnë në një ekuilibër delikat dhe shpesh të paqëndrueshëm. Themelimi i shtetit modern të Izraelit në vitin 1948 shënoi një moment të rëndësishëm në historinë hebraike, duke përmbushur ëndrrën e kahershme të një atdheu për hebrenjtë. Megjithatë, ajo shkaktoi gjithashtu luftën e parë nga shumë, Luftën Arabo – Izraelite të vitit 1948, pasi vendet fqinje arabe refuzuan krijimin e Izraelit dhe luftuan për të parandaluar krijimin e tij. Ky konflikt fillestar hodhi bazat për dekada armiqësie, konflikti dhe përpjekjesh paqesje midis Izraelit dhe fqinjëve të tij arabë. Lufta e Pavarësisë, siç e quajmë Izraelitët, ilustron lidhjen e pazgjydhshme midis luftës dhe

Lufta dhe Paqja në Izrael: Një realitet i dyfishtë!

kërkimit të paqes. Vetë mbijetesa e Izraelit u arrit përmes luftës ushtarake, por shpresa për bashkëjetesë paqësore ka mbetur gjithmonë një ideal udhëzues.

Situata e sigurisë së Izraelit që atëherë është përcaktuar nga ky ekuilibër i pasigurt. Lufta Gjashtë Ditore në 1967, në të cilën Izraeli u përball me Egjiptin, Jordaninë dhe Sirinë, riformoi peizazhin gjeopolitik të rajonit. Izraeli doli fitimtar, duke fituar kontrollin e Bregut Perëndimor, Rripit të Gazës, Jerusalemit Lindor dhe Lartësive të Golanit. Këto përfitime territoriale, ndonëse strategjike, mbollën gjithashtu farat për konfliktin e ardhshëm, veçanërisht me popullsinë palestineze në Bregun Perëndimor dhe Gaza. Lufta i solli Izraelit sigurinë në një afat të shkurtër, por gjithashtu krijoi një situatë ku paqja u bë më e vështirë për t'u arritur. Pushtimi i territoreve palestineze që atëherë ka qenë një nga pengesat qendrore për paqen në konfliktin Izraelito-palastinez, duke ilustruar se si lufta ndonjëherë mund të çojë në sfida të reja në rrugën drejt paqes. Pavarësisht kësaj, ka pasur përpjekje të rëndësishme drejt paqes në historinë e Izraelit. Marrëveshja e Camp David-it e vitit 1979, e nënshkruar nga kryeministri Izraelit Menachem Begin dhe presidenti egjiptian Anëar Sadat, ishin një arritje novatore, që çoi në paqen midis Izraelit dhe Egjiptit. Kjo shënoi herën e parë që një vend arab kishte njohur zyrtarisht Izraelin dhe dëshmoi se paqja ishte e mundur, edhe pas vitesh luftime. Traktati i paqes midis

Izraelit dhe Egjiptit ka qëndruar i fortë që atëherë, duke treguar se edhe pas konfliktit të dhunshëm, pajtimi mund të arrihet. Marrëveshjet e Camp David qëndrojnë si një shembull i fuqishëm se si lufta mund të çojë në paqe kur ekzistojnë kushtet dhe liderët e duhur.

Megjithatë, jo të gjitha përpjekjet për paqe kanë qenë aq të suksesshme. Marrëveshja e Oslos, e nënshkruar në vitet 1990 midis Izraelit dhe Organizatës për Çlirimin e Palestinës (PLO), ofroi shpresë për një zgjidhje paqësore të konfliktit Izraelito – Palestinez. Marrëveshja synonte të krijonte një zgjidhje me dy shtete, me Izraelin dhe një shtet të ardhshëm palestinez që do të jetonin krah për krah në paqe. Ndërsa procesi i Oslos solli njëfarë përparimi, ai përfundimisht u lëkund. Vrasjet, dhuna dhe prishja e besimit nga të dyja palët çuan në kolapsin e procesit të paqes. Intifada e Dytë, një kryengritje palestineze që shpërtheu në vitin 2000, nënvizoi brishtësinë e përpjekjeve për paqe dhe lehtësinë me të cilën mund të rifillojë konflikti. Intifada shkaktoi plagë të thella në shoqëritë Izraelite dhe Palestineze, duke dëshmuar edhe një herë se lufta mund të prishë edhe iniciativat më shpresëdhënëse të paqes.

Në vitet e fundit, Izraeli ka nënshkruar marrëveshje paqesje me disa vende arabe, duke përfshirë Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Bahreinin, përmes Marrëveshjes së Abrahamit. Këto marrëveshje sinjalizojnë një epokë të re nor-

malizimi midis Izraelit dhe disa prej fqinjëve të tij, por ato nuk kanë trajtuar çështjen thelbësore të konfliktit Izraelito – Palestinez. Ndërsa këto marrëveshje kanë hapur rrugë të reja për diplomacinë dhe bashkëpunimin ekonomik, konflikti mbetet i pazgjidhur, duke lënë pyetjen nëse paqja e qëndrueshme është vërtet e arritshme.

Një nga barrierat kryesore për paqen në Izrael ka qenë ndërveprimi midis sigurisë dhe kontrollit territorial. Shqetësimet e sigurisë së Izraelit, veçanërisht në lidhje me grupet si Hamasi dhe Hezbollahu, shpesh kanë çuar në operacione ushtarake në Gaza dhe Liban. Këto operacione janë përshtatur si masa të nevojshme mbrojtëse për të mbrojtur civilët Izraelitë nga sulmet me raketa dhe terrorizëm. Megjithatë, ato përjetësojnë gjithashtu një cikël dhune, ku çdo fushatë ushtarake çon në më shumë viktime, shkatërrime dhe armiqësi nga të dyja palët. Për shembull, Operacioni Protective Edge në 2014, një fushatë ushtarake e nisur nga Izraeli në përgjigje të raketave nga Gaza, rezultoi në mijëra të vdekur dhe shkatërrim të gjerë në Gaza. Ndërsa Izraeli e mbrojti me sukses popullsinë e tij nga sulmet, ndikimi afatgjatë i operacioneve të tilla thëllon ndarjen dhe e bën mundësinë e paqes më të largët.

Industria e armëve gjithashtu luan një rol në ruajtjen e këtij cikli. Shkathësia ushtarake e Izraelit, e nxitur nga sektori i tij i avancuar i mbrojtjes, shihet si një pengesë e nevojshme kundër fqinjëve armiqësorë dhe aktorëve joshtetërorë. Megjithatë, industria e armëve përfiton nga konflikti i zgjatur, pasi tensioni i vazhdueshëm siguron një treg për teknologjitë dhe armët e mbrojtjes. Kjo krijon një nxitje ekono-

mike për të ruajtur një gjendje gatishmërie për luftë, edhe pse përpjekjet për paqen ndiqen në frontin diplomatik. Ky tension midis interesave ekonomike dhe dëshirës për paqe nuk është unik për Izraelin, por ai shton një shtresë tjetër kompleksiteti në situatën e vendit.

Feja dhe ideologjia gjithashtu e ndërlikojnë rrugën drejt paqes. Për shumë Izraelitë, veçanërisht ata në komunitetet fetare sioniste, toka e Izraelit ka një rëndësi të thellë shpirtërore. Ideja e heqjes dorë nga kontrolli mbi çdo pjesë të asaj që ata e konsiderojnë atdheun e tyre biblik nuk është vetëm një çështje politike, por edhe fetare. Kjo e bën kompromisin territorial, i cili shpesh është një komponent kyç i negociatave të paqes, veçanërisht të vështirë. Nga ana tjetër, shumë Palestinezë e shohin pushtimin Israelit si shkelje të së drejtës së tyre për vetëvendosje dhe e shohin luftën kundër Israelit si një luftë për drejtësi dhe identitet kombëtar. Këto besime të forta nga të dyja palët nxisin konfliktin dhe i bëjnë negociatat e paqes edhe më sfiduese.

Pavarësisht këtyre sfidave, dëshira për paqe mbetet e fortë në mesin e shumë Izraelitëve dhe Palestinezëve. Sondazhet tregojnë vazhdimisht se një pjesë e konsiderueshme e popullsisë në të dyja anët mbështet një zgjidhje me dy shtete si rrugën më të mirë drejt paqes. Fraksionet e vijës së ashpër, zgjerimi i vendbanimeve dhe mungesa e një lidhshipi të unifikuar palestinez janë vetëm disa nga pengesat që kanë penguar një përparim në negociatat e paqes. Në fund të fundit, pyetja mbetet: A mund të arrihet paqja në Izrael pa luftë të mëtejshme, apo konflikti është një pjesë e pashmangshme e rrugëtimit drejt pajtimit? Historia e Izraelit sugjeron

se lufta dhe paqja janë thellësisht të ndërlidhura. Mbijetesa e vendit ka varur shpesh nga aftësia e tij për të mbrojtur veten me mjete ushtarake, megjithatë paqja ka qenë gjithmonë qëllimi përfundimtar. Traktatet e paqes me Egjiptin dhe Jordaninë, si dhe Marrëveshjet e fundit të Abrahamit, tregojnë se paqja është e mundur, edhe pas vitesh konflikti. Por për sa kohë që konflikti Izraelito – Palestinez mbetet i pazgjidhur, fantazma e luftës do të vazhdojë të shfaqet mbi rajonin.

Në përfundim, realiteti i dyfishtë i luftës dhe paqes në Izrael pasqyron përvojën më të gjerë njerëzore të konfliktit dhe pajtimit. Ndërsa lufta ka qenë shpesh një mjet i domosdoshëm mbijetese për Izraelin, ajo gjithashtu ka krijuar sfida të reja në rrugën drejt paqes. Ndjekja e paqes mbetet një aspiratë thellësisht e mbajtur, por është ajo që kërkon navigim të kujdesshëm të shqetësimeve të sigurisë, ndarjeve ideologjike dhe realiteteve politike. Nëse paqja mund të arrihet pa hijen e luftës mbetet një pyetje e hapur, por shpresa për një të ardhme të përcaktuar nga paqja, në vend të konfliktit, vazhdon të frymëzojë përpjekjet drejt zgjidhjes.

Ndërsa Izraeli reflekton mbi kompleksitetin e paqes dhe luftës, viti i ri i Rosh Hashanah ofron mundësi të reja. Tradicionalisht, Rosh Hashanah është një kohë për reflektim, lutje dhe ndjekje të përmirësimit personal dhe kolektiv. Tingulli i shofarit nuk është vetëm një thirrje për ripërtëritje shpirtërore, por edhe një kujtesë e sfidave që qëndrojnë përpara, veçanërisht në lidhje me konfliktin e vazhdueshëm dhe aspiratat për një të ardhme më paqësore. L'Shanah Tova!

***Ekspert i Sigurisë
Ndërkombëtare.**



Arrestohet ish-presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta

Kryetari i Partisë së Lirisë në Shqipëri, Ilir Meta, është arrestuar me urdhër të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit (SPAK) më 21 tetor.

Meta kishte shërbyer në postin e presidentit të Shqipërisë nga viti 2017 deri më 2022.

Përveç postit të presidentit, ai kishte qenë edhe kryeministër, ministër i Jashtëm dhe kishte edhe poste të tjera të larta.

Policia dhe SPAK-u ende nuk kanë dalë zyrtarisht me ndonjë njoftim për shtyp lidhur me arrestimin e Metës.

Meta po hetohet në SPAK për skandalin CEZ-DIA, si dhe lobimin në SHBA.

Nuk dihet ende se për cilën çështje është ekzekutuar urdhër-arresti.

Ndërkohë, ndaj Metës dhe familjes së tij ka edhe hetim pasuror.

Meta kishte njoftuar për një konferencë për media për në orën 13:40 dhe ishte duke udhëtuar drejt selisë së partisë së tij kur është arrestuar.

Ilir Meta u zgjodh për herë të parë deputet në vitin 1992 dhe ka shërbyer në shumë poste të rëndësishme. Ai ka shërbyer si Kryeministër i Shqipërisë nga 28 tetori 1999 deri më 29 janar 2002. Pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2001, ai u rizgjodh si Kryeministër, por dha dorëheqjen më 29 janar 2002.

Në vitin 2004, ai themeloi Lëvizjen Socialiste për Integrim (LSI) që u shndërrua më pas në Partinë e Lirisë.

Meta mbajti postin e kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë nga 10 shtatori 2013 deri më 28 prill 2017. Pas përfundimit të mandatit si Kryetar i Kuvendit, ai u zgjodh President i Republikës, detyrë që e mbajti deri në vitin 2022.

Shqipëria çel grup-kapitullin e parë me Bashkimin Evropian!

Shqipëria ka hapur kapitullin e parë të negociatave për anëtarësim me Bashkimin Evropian sot më 15 tetor.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në konferencën e përbashkët me ministrin hungarez të Punëve të Jashtme dhe Tregtisë, Peter Szijjarto, në Luksemburg, e vlerësoi si historik këtë moment.

“Çelja e kapitujve përbën arritje të madhe dhe shënon gurthemel historik në rrugëtimin e përbashkët. Çdo sukses që Shqipëria në procesin e BE-së duhet të shihet si hap për të gjithë rajonin. Për Shqipërinë nuk ka tjetër të ardhme”, tha Rama.

Sipas metodologjisë së re, në procesin e zgjerimit fillimisht është hapur grupi i parë ku janë kapitujt që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit. Progresi në këtë fushë do të diktojë edhe përparimin në tërë procesin negociator.

Kryediplomati hungarez Szijjarto tha se procesi i zgjerimit të BE-së duhet të përshpejtohet.

“Na duhet energjia e re dhe kjo do të vijë nga hapësira e Ballkanit Perëndimor. Është në interes të BE-së që zgjerimi të përshpejtohet. Na duhet të marrim hapa urgjente për të ruajtur besueshmërinë e politikës së zgjerimit. Duhet të përshpejtojmë procedurën e zgjerimit tani”, tha ai.

Szijjarto theksoi se Shqipëria është gati për t’iu bashkuar BE-së, duke shtuar se shpreson që Brukseli të bëjë “detyrat burokratike”, dhe që një tjetër konferencë të realizohet brenda presidencës hungareze.



Edhe komisioneri për zgjerimin e BE-së, Oliver Varheyli nënvizoi rëndësinë e zgjerimit të BE-së.

“Dua të falënderoj presidencën e Hungarisë që vendosi zgjerimin si përparësi politike dhe bëri përpjekje të jashtëzakonshme për ta nxitur më tej. Na duhet zgjerimi, që BE-ja të bëhet më e forte”, tha Varheyli.

Shqipëria ka pritur disa vite që të hapë negociatat për anëtarësim. Tani, pas hapjes së kapitujve të parë pritet që procesi të jetë më i shpejtë.

Me hapjen e grupit të parë të kapitujve, është zyrtarizuar ndarja e paketës ku Tirana ishte së bashku me Maqedoninë e Veriut.

Për disa vite vendimet janë marrë paralelisht për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, ndërsa tash rrugët janë ndarë.

Rruga e Shkupit drejt BE-së vazhdon të jetë e bllokuar nga Bullgaria, për shkak të mosmarrëveshjeve

dypalëshe.

Lidhur me ndarjen e rrugës evropiane të Tiranës dhe Shkupit, Rama shprehu keqardhje.

“Ndihej në siklet sepse më duhet të mendoj për poshtërimin e Maqedonisë së Veriut që u detyrua të ndryshonte edhe emrin për t’u futur në këtë proces. U qëndroj të njëjtave gjëra që kam thënë për miq tanë bullgarë, sepse historia nuk mund të jetë arsyeja për të ndaluar bisedimet e anëtarësimit për asnjë vend”, tha Rama.

Arsyeja e ndarjes së Shqipërisë në këtë rrugëtim drejt BE-së, është se Maqedonia e Veriut nuk e ka përmbushur kushtin e vendosur nga Bullgaria, që të përfshijë në preambulën e Kushtetutës minoritetin bullgar. Ky kusht është futur në kornizën negociuese që Parlamenti maqedonas votoi në korrik të vitit 2022, propozim që njihet edhe si “propozimi francez”. Vendimi për hapjen e kapitullit të parë u mirëprit nga presidenti

shqiptar, Bajram Begaj, i cili tha se mbush me shpresë shqitarët për realizimin “e ëndrrës së kahershme ‘E duam Shqipërinë si gjithë Evropa’”.

Shqipërinë e ka uruar edhe presidenja e Kosovës, Vjosa Osmani. Ajo tha se Shqipëria, Kosova dhe vendet e tjera demokratike të rajonit duhet të vazhdojnë të bëjnë përparim në rrugën evropiane “që është thelbësore për të siguruar paqe të qëndrueshme dhe stabilitet, jo vetëm për rajonin, por gjithë Evropën”.

Grupkapitulli i parë është një ndër më të rëndësishmit, pasi prek fusha thelbësore, siç janë; drejtësia, gjyqësori, funksionimi i institucioneve demokratike, prokurimi publik apo reforma e administratës publike. Në këtë



grup, siç quhet ndryshe edhe ‘bazat’ ose ‘themeloret’, përfshin edhe prokurimet publike, statistikat dhe kontrollin financiar. Ky grup-kapitull hapet i pari dhe mbyllet në fund të procesit të integrimit. Progresi në këtë grup do të

përcaktojë ritmin e përgjithshëm të negociatave.

Delegacioni

Kryeministri Edi Rama ndodhet në Luksemburg, së bashku me Ministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme Igli Hasani, Ministren e Shtetit dhe Kryenegociatoren Majlinda Dhuka, Ministren e Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Adea Pirdeni, si dhe një delegacion të përbërë nga negociatorët përgjegjës për kapitujt përbërës të grupkapitullit të parë.

Negociatat për anëtarësim shënojnë momentin kyç në proceset integruese të një vendi për në BE. Negociatat zhvillohen mes ministrave dhe ambasadorëve të qeverive të vendeve anëtare dhe vendit kandidat përmes Konferencës Ndërqeveritare. Ato përfshijnë marrjen përsipër nga vendi kandidat të përafritit të plotë të legjislacionit të BE-së (acquis), zbatimin e tij, si dhe zbatimin e reformave të tjera ligjore, politike, ekonomike, administrative dhe reformave të tjera për të përmbytur kriteret për anëtarësim. jen e negociatave me Shqipërinë. Shqipëria aplikoi për anëtarësim në BE në prill 2009 dhe iu dha statusi kandidatit për në BE në qershor 2014.

GRUP KAPITULLI I PARË PËR TË CILËT SHQIPËRIA HAP NEGOCIATAT

-Funksionimi i institucioneve demokratike

-Reforma e administratës publike

-Kapitulli 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore

-Kapitulli 24 – Drejtësia, liria dhe siguria

